



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL. Anr.321/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Bujar Muzaqi, kryesues, Violeta Husaj Rugova dhe Hajriz Hoti anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Baftishahe Zenelaj, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, dega Suharekë, të parashtruar kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 25.10.2025, merr këtë :

V E N D I M

REFUZOHET E PABAZUAR ankesa, ZL. Anr.321/2025 datë 23.10.2025, e parashtruar nga Baftishahe Zenelaj, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega Suharekë, të parashtruar kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me datën 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 23.10.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesë nga Baftishahe Zenelaj, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega Suharekë, në të cilën në të cilën kërkon rinumërim të votave në komunën e Suharekës me arsyetimin se në shumë vendvotime i mungojnë votat me të cilën ka dyshime për gabime gjatë numërimit si dhe bartje të votave nga njëri kandidat tek tjetri, ku shumë votues kanë deklaruar për votën e tyre ndërsa votat e tyre mungojnë. Parashtruesja e ankesës thekson se sa i përket votave me post ka parregullsi të cilën siç thotë e dëshmojnë dy fotografi të bashkangjitura. Parashtruesja e ankesës thekson se me datën 19.10.2025 ora 21:46 min, kanë qenë të përditësuara 7 kuti të numëruara nga gjithsej 9 kuti shprehur në përqindje 77.78% të votave të numëruara. Pas kësaj përditësohen të dhënat përsëri për 7 kuti të numëruara nga gjithsej 9 kuti në përqindje 77.78% i datës 19.10.2025 ora 22:21 min. Duke u bazuar në fakte dhe në deklarata e votuesve, kërkon nga që të urdhërohet rinumërimi i plotë në komunën e Suharekës për të siguruar integritet dhe saktësi në rezultatin zgjedhor.

KQZ në përgjigjen në ankesë thekson se KQZ, pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të palës ankuese në lidhje me kërkesën e juaj jep sqarimet/ përgjigjet si në vijim: Bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/ L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e

miratuar më 01.10.2025, Nr.01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN. Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr. 16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QI(N)). KQZ, ju njofton se, rezultatet përfundimtare të procesit zgjedhor, shpallen nga KQZ-ja pas përfundimit të numërimit të të gjitha fletëvotimeve nga vendvotimet e rregullta; fletëvotimeve nga votimi me kusht; fletëvotimet nga votimi i personave me nevoja të veçanta; fletëvotimeve nga votimi jashtë Kosovës; vendosjes për ankesat eventuale nga PZAP dhe Gjykata Supreme dhe pas përfundimit të të gjitha procedurave në QNR, ku rezultati i publikuar është i ankimeshëm nga subjekte politike dhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numërimin e votave të tyre. Pra, në momentin e publikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të LPZ, pala mund të ushtrojnë ankesë në afatin brenda dyzet e tetë (48) orëve në PZAP. Andaj, pas analizimit të lëndës është vërejtur se në pjesën e parë të ankesës, pala ankuese e ka paraqitur jashtë afatit ligjor për paraqitjen e ankesës, sepse pas konfirmimit të ZEKKZ në komunën e Suharekës, aktiviteti i QKN-së është përmbyllur me datën 16.10.2025, ditën e enjte, në ora 15:45, ndërsa pala ankesën e ka parashtruar me datën 23.10.2025. Pra nuk është brenda afatit ashtu siç parashihet me nenin 105, paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar.

Ndërsa në lidhje me pretendimin e dytë të palës lidhur me numërimin e votave me postë në QNR, Procesi i numërimit të votave në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) është zhvilluar në përputhje me Rregulloren Zgjedhore Nr. 14/2024, Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) ku ekipet e numërimit kanë bërë numërimin e votave të kandidatëve në transparencë të plotë, ku fletëvotimi është prezantuar në ekran dhe është parë nga vëzhguesit e akredituar. Krahas fletëvotimeve, në ekran është prezantuar edhe pamja e sistemit elektronik ku figurojnë numrat e kandidatëve të cilët regjistrohen në sistem. Ndërsa në nenin 20 të Rregullores Zgjedhore nr. 14/2024 për Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, parashihet procedura e numërimit të fletëvotimeve në QNR, përkatësisht në paragrafin 9 të nenit 20 parashihet se: Zarfet e votimit me postë hapen dhe numërohen pas përfundimit të krahasimit të listave votuese të përcaktuara në nenin 18 të kësaj rregullore si dhe pas përfundimit të numërimit të votave në përfaqësi diplomatike. Sa i përket pretendimeve të palëve ankuese që mbështeten në deklaratimet e personave, duhet theksuar se, në kuptim të nenit 4 paragrafi 1.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara. Publikimi i votës cenon këtë parim dhe shpërfaq vullnetin e votuesit. Në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur se palët ankuese, nuk ka bashkëngjitur prova të mjaftueshme që do të mund të dëshmonin apo mbështesnin pretendimet e saj të paraqitura në ankesë. Gjithashtu KQZ njofton PZAP se, me datën 22.10.2025, në orën 20:30, ka përfunduar procesi i administrimit në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën dhe përgjigjen në ankesë ka gjetur se:

-Ankesa është e pabazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës, përgjigjes në ankesë të KQZ-së, vlerësoj se pretendimet në ankesën e Baftishahe Zenelaj, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, dega Suharekë, në të cilën kërkon rinumërim të votave në komunën në Suharekë me arsyetimin se në shumë vendvotime i mungojnë votat me të cilën ka dyshime për gabime gjatë numërimit si dhe bartje të votave nga njëri kandidat tek tjetri, dhe pretendimet lidhur me parregullsitë të numrimit të votave me post ka parregullsi, për Panelin këto pretendime janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga pretendimet e theksuara në ankesë me të cilën kërkon te rinumërohen votat dhe arsyetimi për parregullsitë sa i përket numërimit të votave me post, Paneli këto pretendime nuk ka arritur që të i vërtetoj se ka pasur shkelje apo parregullsi për të cilat pala ankuese pretendon me ankesën e tij, kjo pasi që paraqitësi i ankesës nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë provë dhe nuk ka arritur me ankesë të argumentoj pretendimet e tij se i mungojnë votat, ndërsa pretendime e theksuara në ankesë tani për tani mbeten në nivel të supozimit nga se nuk janë argumentuar me fakte dhe me prova konkrete.

Sa i përket pretendimeve të palës ankuese që mbështetet në deklarin e disa personave – votuesve, sipas vlerësimit të panelit bazuar në nenin 4 paragrafi 1.3 të LZP, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara, gjer sa shpërfaqja e vullnetit të votuesve në parim cenon fshehtësinë votës, prandaj edhe për këtë arsye nuk e mori parasysh këtë pretendim.

Andaj, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të përgjithësuara, të pa argumentuara dhe të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj si të pa bazuara, pasi që njëri nga pretendimet ankimore dhe atë sa i përket votave me postë është parashtruar brenda afatit ligjor, po ashtu për faktin se nga veprimet e përshkruar në ankesë, parashtruesja e ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj me asnjë provë të vetme se me këto veprime ka pasur shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhje apo të Rregullave Zgjedhore të KQZ-së.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesja e ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nën përcaktohet se “*Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*”.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar në nenin 117 paragrafi 3, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.321/2025 datë 25.10.2025

Kryesues i Panelit,

Bujar Muzaqi



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.